



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*  
*Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice*

---

**Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë,**

Në mbështetje të nenit 10 paragraf 1, nën paragraf 1.1 dhe 1.2 të Ligjin nr.08/L-013 për të Drejtat Pronësore të Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës, në përputhje me nenin 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 8 (nën paragrafi 1.4) të Rregullores QRK - NR. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2022, si dhe nenin 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr. 15, 12.09.2011),

Nxjerr:

**RREGULLORE MD - Nr.07/2023<sup>1</sup>**  
**PËR PROCEDURËN E PËRCAKTIMIT DHE VERIFIKIMIT TË**  
**RECIPROCITETIT, KUSHTET, PËRMBAJTJEN DHE MËNYRËN E**  
**MIRËMBAJTJES SË BAZËS SË TË DHËNAVE PËR FITIMIN E TË DREJTËS SË**  
**PRONËSISË MBI PRONËN E PALUAJTSHME NGA TË HUAJT NË KOSOVË**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Kjo Rregullore ka për qëllim të rregullojë procedurat e përcaktimit dhe verifikimit të reciprocitetit, organin e autorizuar për përcaktimin e reciprocitetit, kushtet, përmbajtjen dhe mënyrën e mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për ekzistimin e reciprocitetit me vende të veçanta për fitimin e të drejtave pronësore mbi pronën e paluajtshme nga të huajt në Republikën e Kosovës.

---

<sup>1</sup> Rregullore MD - Nr.07/2023 për Procedurën e Përcaktimit dhe Verifikimit të Reciprocitetit, Kushtet, Përmbajtjen dhe Mënyrën e Mirëmbajtjes së Bazës së të Dhënave për Fitimin e të Drejtës së Pronësisë mbi Pronën e Paluajtshme nga të Huajt në Kosovë, e nënshkruar nga Ministria e Drejtësisë, më datë 18.07.2023.

## **Neni 2**

### **Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga të gjitha Institucionet e Republikës së Kosovës të cilat kanë përgjegjësi vërtetimin e fitimit të drejtës së pronësisë në pronë të paluajtshme nga personi i huaj fizik apo juridik, zbatimin e procedurës për përcaktimin dhe verifikimin e reciprocitetit si dhe verifikimin e kufizimeve ligjore për fitimin e kësaj të drejte.

## **Neni 3**

### **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

1.1. **Ligji** - Ligji Nr.08/L-013 Për të Drejtat Pronësore të Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës;

1.2. **Ministria** - Ministria e Drejtësisë;

1.3. **RDPP** - Regjistri i të Drejtave të Pronës së Paluajtshme.

2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin si në përkufizimet e Ligjit për të Drejtat Pronësore të Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës.

## **Neni 4**

### **Institucioni përgjegjës**

Përcaktimin e reciprocitetit dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave për reciprocitetin me vende të veçanta mbi të drejtat pronësore në pronën e paluajtshme të shtetaseve të huaj e bënë Ministria e Drejtësisë, përmes Departamentit Ligjor në bashkëpunim me Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar kur interferohet në kompetenca të këtij Departamenti.

## **Neni 5**

### **Procedura e përcaktimit të reciprocitetit**

Për dhënien e pëlqimit për fitimin e të drejtës së pronësisë nga personat e të huaj në pronat në Republikën e Kosovës, vendoset me vendim, në procedurë administrative, e cila zhvillohet në pajtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjin për të Drejtat Pronësore të Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës dhe me këtë Rregullore.

## **Neni 6**

### **Kërkesa për përcaktimin e reciprocitetit**

1. Përcaktimi dhe verifikimi i reciprocitetit bëhet me kërkesën e personit të huaj, i cili ka për qëllim të fiton të drejtën e pronësisë së pa luajtshme të caktuar apo të personit i cili ka qëllim ta shesë atë pronë të paluajtshme. Kërkesa parashtrohet në Departamentin Ligjor të Ministrisë Drejtësisë.

2. Kërkesa për vendosjen e reciprocitetit përmban:

2.1. dëshminë për të dhënat personale dhe shtetësinë e blerësit, si:

2.1.1. kopja e vërtetuar e të një dokumenti personal që tregon emrin dhe mbiemrin, datën e lindjes dhe shtetësinë, ose origjinalin apo kopjen e vërtetuar të një dokumenti publik që tregon të dhëna për personin juridik, selinë dhe vendin e regjistrimit të personit juridik;

2.1.2. nëse i huaji ka shtetësi të dyfishtë, dëshminë e qëndrimit të fundit të përhershëm, sipas nenit 5, paragrafi 3 të Ligjit;

2.1.3. nëse i huaji nuk ka shtetësi, një deklaratë në përputhje me nenit 5, paragrafi 4 të Ligjit;

2.1.4. të dhënat e personit të autorizuar për përfaqësim apo pranimit të letrave.

2.2. dokumentin me të cilin i huaji dëshmon të drejtën e vendosjes së reciprocitetit, se a vendoset në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara me ligj - reciprociteti ligjor apo me marrëveshje ndërkombëtare - reciprociteti i kontraktuar, me të cilën është përcaktuar reciprociteti, përkatësisht a janë caktuar kushtet e fitimit të pronësisë mbi pronat e paluajtshme nga të huajt sipas nenit 4 paragrafi 1 të Ligjit;

2.3. dëshminë e pronësisë së tjetërsuesit/shitësit mbi pronën e pa luajtshme përkatëse, apo Certifikatën e pronësisë, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;

2.4. bazën juridike për fitimin e pronësisë, nga shtetasi i huaj;

2.5. dëshminë e pagesës së tarifës së përcaktuar me vendimin e Ministrit të Drejtësisë.

3. Dokumentet nga paragrafi 2 i këtij neni dorëzohen në formë të dokumentit publik në origjinal ose në kopje të vërtetuar.

4. Nëse dokumentacioni nuk është i kompletuar, Ministria mund të kërkon nga parashtruesi i kërkesë kompletimin e dokumentacionit.

## **Neni 7**

### **Informatat plotësuese**

1. Njësia kompetente e Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim të kompletimit të të dhënave për përcaktimin dhe verifikimin e reciprocitetit, i dërgon kërkesë Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) me të cilën kërkon të dhëna për pronën e pa luajtshme, e cila është objekt i kërkesës për fitimin e pronësisë nga i huaji.

2. Të dhënat e kërkuara përfshijnë:

2.1. konfirmimin e të dhënave për pronën e paluajtshme - njësinë kadastrale si: komuna, zona kadastrale, numri i njësisë kadastrale, sipërfaqja, përputhja e të dhënave nga pjesa grafike dhe RDPP;

2.2. të dhënat mbi llojin e pronës si tokë - bujqësore, tokë pyjore, tokë ndërtimore, tokë ujore; tokë djerrë, ndërtesë apo njësi e ndërtesës si dhe statusin e pronës si pronë private, publike-shtetërore apo shoqërore;

2.3. të dhënat se a përfshihet prona e pa luajtshme objekt i kërkesë, në pronat në të cilat, personat e huaj nuk mund të fitojnë të drejtën e pronësisë, sipas nenit 7 të Ligjit, përfshirë:

2.3.1. pasuritë natyrore;

2.3.2. të mirat publike në përdorim të përgjithshëm;

2.3.3. toka bujqësore në pronësi publike;

2.3.4. pyje dhe toka pyjore në pronësi publike;

2.3.5. pronat publike të luajtshme apo të paluajtshme të shpallura trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë;

2.3.6. prona e paluajtshme e cila gjendet brenda 1 kilometri nga kufiri;

2.3.7. prona e pa luajtshme e cila gjendet në zonën e cila paraqet mbrojtje të interesit dhe sigurisë së shtetit dhe me ligj të veçantë shpallet se personi i huaj nuk do të ketë të drejtën e pronësisë;

2.3.8. prona e pa luajtshme në pronësi publike të cilat, sipas ligjeve në fuqi, nuk mund të kalojnë në pronësi private as të shtetasve të Kosovës.

3. Agjencia Kadastrale e Kosovës i dërgon të dhënat të cilat i posedon. Të dhënat nga nën paragrafi 2.3 të këtij neni, që nuk i posedon Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe të dhënat tjera

të nevojshme për përcaktimin e reciprocitetit, Ministria i kërkon nga institucionet tjera përkatëse publike –qendrore dhe lokale në Republikën e Kosovës.

4. Të dhënat nga ky nen mund të merren edhe përmes bazës së të dhënave elektronike.

#### **Neni 8**

##### **Marrja e informatave për legjislacionin e shtetit të huaj**

1. Në procedurën e verifikimit të reciprocitetit, Ministria merr informata se si është rregulluar fitimi i të drejtave pronësore me legjislacionin e shtetit të shtetasit të huaj përfshirë mënyrën e fitimit të drejtave pronësore për personat fizik apo juridik në Republikën e Kosovës, në pronat e paluajtshme të llojit të njëjtë dhe që ndodhen në zonë të njëjtë.

2. Informatat nga paragrafi 1 i këtij neni, Ministria i merr me kërkesë në shtetin e të huajit, duke kontrolluar drejtpërdrejt legjislacionin e shtetit të huajit ose përmes burimeve zyrtare.

3. Nëse legjislacioni i shtetasit të huajit për fitimin e së drejtës pronësore nga të huajt nuk është i njëjtë në tërë territorin e shtetit, Ministria merr informacion për legjislacionin që vlen për zonën ku i huaji e ka vendbanimin e përhershëm.

#### **Neni 9**

##### **Verifikimi i reciprocitetit sipas legjislacionit të shtetit të huaj**

1. Pas marrjes së të dhënave nga legjislacioni i shtetit të huaj, së pari verifikohet se a mundet, sipas legjislacionit të atij shtetit, shtetasi apo personi juridik i Republikës e Kosovës, të fitojnë të drejtën e pronësisë mbi një pronë të njëjtë dhe që gjendet në zonë të njëjtë në këtë shtet, në mënyrën, procedurat dhe kushtet e kërkuara nga shtetasi i huaj.

2. Nëse Ministria konstaton se një shtetas apo personi juridik i Republikës e Kosovës, mund të fitojë të drejtën e pronësisë mbi pronën e pa luajtshme të njëjtit lloj që ndodhen në të njëjtën zonë në vendin e të huajit, gjithashtu vlerëson se a përcakton legjislacioni i shtetit të huajit kushte të njëjta ose të ngjashme për fitimin e të drejtës pronësore, mbi të njëjtin lloj të pronës së paluajtshme që ndodhen në zonë të njëjtë.

#### **Neni 10**

##### **Verifikimi i reciprocitetit sipas bazës së të dhënave - regjistrin të reciprocitetit sipas shtetit**

1. Pas krijimit dhe konsolidimit të regjistrin të reciprocitetit për shtetet individuale, sipas nenit 14 të kësaj Rregulloreje, për vërtetimin e ekzistimit të reciprocitetit për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme, sipas kërkesës së kompletuar të një shtetasi të huaj, Ministria e kontrollon regjistrin e të dhënave për shtetin e huaj përkatës.

2. Nëse pas kontrollimit të regjistrimit konstatohet se tashmë është vërtetuar reciprociteti, do të kontrollojë edhe nëse ka pasur ndryshime në legjislacionin e shtetit të huaj.

3. Kur të konstatohet se legjislacioni i shtetit të huajit nuk ka ndryshuar, ose se dispozitat e ligjit që janë të zbatuara në rastin konkret nuk kanë ndryshuar, nxjerr vendim me të cilin konstaton se ekziston reciprociteti. Vendimi përmban arsyetimin që përfshinë një shpjegim të shkurtër të pretendimit të kërkuarit dhe një referencë në legjislacionin e shtetit të huaj në bazë të cilit është vendosur çështja.

4. Në rastet nga ky nen, vendimi nxirret në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës së kompletuar.

## **Neni 11** **Nxjerrja e Vendimit**

1. Nëse pas vlerësimeve të kryera konstatohet se, sipas legjislacionit të atij shteti, shtetasi apo personi juridik i Republikës së Kosovës, nuk mund të fiton të drejtën e pronësisë mbi një pronë të njëjtë dhe që gjendet në zonë të njëjtë në këtë shtet, në mënyrën, procedurat dhe kushtet e kërkuara nga shtetasi i huaj, Ministria nxjerr vendim me të cilin konstaton se reciprociteti nuk ekziston dhe kërkesa e shtetasit të huaj refuzohet.

2. Personit të huaj të cilit nuk i është dhënë pëlqimi për fitimin e të drejtës së pronësisë, nuk mund ta përsëritë kërkesën për dhënien e pëlqimit për fitimin e të drejtës së pronësisë në pronën e njëjtë, pa kaluar afati prej pesë (5) vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës, e cila është refuzuar.

3. Përfundim nga paragrafi 2 i këtij neni, përbënë rasti kur personi huaj dëshmon se në vendin përkatës kanë ndryshuar faktet relevante që i lejojnë këtij personi fitimin e të drejtës së pronësisë për shkak të një marrëveshje ndërkombëtare apo reciprocitetit në pajtim me ligjin në fuqi.

4. Pas vlerësimeve të kryera, nga neni 8 i kësaj Rregulloreje, Ministria nxjerr vendim me të cilin konstaton se ekziston reciprociteti.

5. Vendimi nxirret në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës së kompletuar.

6. Pala e pa kënaqur dhe personat që kanë ndonjë interes juridik, kundër Vendimit të Ministrisë, mund të iniciojnë konflikt administrativ në Gjykatën kompetente.

7. Vendimi me të cilin është vërtetuar se ekziston reciprociteti vlen një (1) vit nga dita e plotfuqishmërisë.

## **Neni 12**

### **Krijimi i të drejtës pronësore dhe regjistrimi i sajë**

1. Të gjitha institucionet kompetente për krijimin apo njohjen e të drejtës pronësore të personave të huaj fizik apo juridik, krijimin e kësaj të drejte duhet bazuar në vendimin e plotfuqishëm dhe të vlefshëm për ekzistimin apo mos ekzistimin e reciprocitetit. Akti juridik për krijimin e të drejtës pronësore përmban edhe informatat nga vendimi për vërtetimin e ekzistimit apo jo të reciprocitetit me shtetin përkatës.
2. Me rastin e regjistrimit të pronës së pa luajtshme në RDPP, përveç të dhënave tjera, të shtohet se e drejta pronësore e krijuar i përket personit të huaj fizik apo juridik të shtetit të caktuar.
3. Në rastet kur fitues i të drejtës së pronësisë është shteti i huaj, kërkesës për regjistrim duhet bashkëngjitur vendimin përkatës nga Ministria e Punëve të Jashtme.

## **Neni 13**

### **Baza e të dhënave për reciprocitetin**

1. Baza e të dhënave për reciprocitetin përmban:
  - 1.1. të dhënat e reciprocitetit sipas shtetit;
  - 1.2. regjistrin e vendimeve të nxjerra sipas shtetit;
  - 1.3. evidencën e regjistrimeve në RDPP të drejtës në pronë të paluajtshme të shtetasve të huaj;
  - 1.4. informatat për reciprocitetin për fitimin e të drejtës së pronësisë në prona të paluajtshme në mes të Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera.
2. Ministria krijon dhe mirëmban bazën e të dhënave, në formë analoge dhe elektronike, për reciprocitetin në të drejtat pronësore të shtetasve të huaj.

## **Neni 14**

### **Të dhënat e reciprocitetit sipas shtetit**

1. Ministria do të krijojë dhe mban të dhënat për ekzistimin e reciprocitetit në shtetet e veçanta.
2. Të dhënat nga paragrafi 1 i këtij nenin për secilin vend përmbajnë informacionet si në vijim:
  - 2.1. llojet individuale të pronave të paluajtshme dhe sipërfaqet për të cilat ekziston reciprocitet dhe për të cilat nuk ekziston reciprocitet;

2.2. bazën ligjore që rregullon fitimin e të drejtës së pronësisë për çdo lloj prone të paluajtshme;

2.3. zonën në të cilën ndodhet pasuria paluajtshme;

2.4. mënyrën e fitimit të së drejtës pronësore.

3. Të dhënat nga paragrafi 2 i këtij neni merren nga vendimi i nxjerrë sipas kësaj Rregullore për verifikimin e reciprocitetit dhe përfshihen në regjistër pas plotfuqishmërisë së vendimit.

4. Të dhënat nga ky nen, publikon në faqen zyrtare të Ministrisë.

### **Neni 15**

#### **Regjistri i vendimeve të nxjerra sipas shtetit**

1. Me qëllim të monitorimit statistikor, Ministria themelon dhe mban evidencë për vendimet e nxjerra në bazë të Ligjit.

2. Të dhënat statistikore për vendimet e nxjerra sipas kësaj Rregullore, Ministria i publikon në faqen zyrtare të saj, çdo gjashtë (6) muaj.

### **Neni 16**

#### **Evidenca e regjistrimeve në RDPP**

1. AKK - Zyra Kadastrale Komunale është e obliguar që të dhënat për regjistrimin në regjistrin e të drejtës së pronësisë së personave të huaj mbi pronat e pa luajtshme në Republikën e Kosovës, t'ia dërgon në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e regjistrimit, Ministrisë së Drejtësisë. Të dhënat dërgohen në formë elektronike apo fizike.

2. Ministria mbanë evidencën e regjistrimeve të drejtës së pronësisë të personave të huaj fizik dhe juridik mbi pronat e pa luajtshme në Republikën e Kosovës.

### **Neni 17**

#### **Informatat për reciprocitetin**

1. Nga të dhënat e reciprocitetit sipas shtetit, si dhe merrja e informatave për fitimin e të drejtës pronësore sipas legjislacionit të shtetit të huaj përfshinë mënyrën e fitimit të të drejtave pronësore për personat e huaj fizik apo juridik me seli në Republikën e Kosovës, në pronat e paluajtshme të të njëjtit lloj dhe që ndodhen zonë të njëjtë si dhe kufizimet për fitimin e kësaj të drejte, Ministria përgatitë informatat mbi reciprocitetin për fitimin e të drejtës së pronësisë në prona të pa luajtshme në mes të Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera përveç shteteve anëtare të BE-së.



2. Në këtë informatë përfshihen emri i shtetit, ekzistimin apo jo të reciprocitetit, kufizimet dhe kushtet për fitimin e të drejtës së pronësisë nga shtetasit e huaj në atë shtet.

3. Informatat nga ky nen, publikohen në faqen zyrtare të Ministrisë.

## **Neni 18**

### **Shtojcat**

1. Pjesë e kësaj rregulloreje janë shtojcat si në vijim:

1.1. Shtojca nr.1: Kërkesë për dhënien e pëlqimit personave të huaj për fitimin e të drejtës së pronësisë në prone të pa luajtshme në Republikën e Kosovës;

1.2. Shtojca nr. 2: Kërkesë për të dhënat e pronave të pa luajtshme për procedurën e verifikimit të reciprocitetit;

1.3.Shtojca nr.3: Informatat për reciprocitetin për fitimin e të drejtës së pronësisë në prona të pa luajtshme në mes të Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera përveç shteteve anëtare të BE-së.

## **Neni 19**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albulena Haxhiu**

Ministre e Ministrisë së Drejtësisë

18.07.2023



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Drejtësisë -Ministarstvo Pravde– Ministry of Justice*

**KËRKESË**  
**PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PERSONAVE TË HUAJ PËR FITIMIN E**  
**TË DREJTËS SË PRONËSISË NË PRONË TË PALUAJTSHME NË**  
**REPUBLIKËN E KOSOVËS**

**Të dhënat e parashtruesit të kërkesës:**

|  |  |
|--|--|
| Emri dhe mbiemri/emri i personit juridik |  |
| Adresa e banimit apo vendqëndrimit/selia |  |
| Numri identifikues                       |  |
| Shtetësia                                |  |
| Tel. / e-mail                            |  |

**Të dhënat për të autorizuarin për përfaqësim apo për pranim të shkresave:**

|   |  |
|---|--|
| Komuna  |  |
| Zona Kadastrale   |  |
| Numri i parcelës/ adresa dhe numri i ndërtesës apo pjesës së ndërtesës                |  |
| Lloji i pronës së paluajtshme   |  |
| Të dhënat për pronarin apo shfrytëzuesin e regjistruar                                |  |
| Dëshmia e pronësisë së tjetërsuesit/shitësit të pronës                                |  |
| Baza juridike e fitimit të pronësisë nga i huaj (Kontrata e shitblerjes, faljes etj.) |  |

**Të dhënat për pronën e pa luajtshme për të cilën kërkohet pëlqimi për fitimin  
pronësisë:**

**Vërejtje / të dhëna shtesë të parashtruesit të kërkesës:**

---

---

---

---

---

Në \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi parashtruesit të kërkesës /të autorizuarit

**Kërkesës së shkruar duhet bashkëngjitur:**

1. Baza juridike e fitimit të pronësisë nga i huaj (Kontrata e shitblerjes, dhuratës, mbajtjes etj.) në origjinal apo kopjen e vërtetuar.
2. Dëshminë për pronësinë e tjetërsuesit /shitësit të pronës përkatëse- certifikatën e pronësisë.
3. Dëshminë për shtetësinë e fituesit të drejtës së pronësisë, si kopja e vërtetuar e pasaportës apo dëshmia për statusin e personit juridik- dokumentin nga regjistri i regjistrimit.
4. Nëse parashtruesin e kërkesës e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar, është e nevojshme të bashkëngjis autorizimin në origjinal apo kopjen e vërtetuar.
5. Dëshmia e pagesës së tarifës së përcaktuar.

\*Nëse është e nevojshme pala mund të ftohet që brenda afatit të caktuar të bashkëngjis edhe dokumente tjera.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Drejtësisë -Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice*

---

**KËRKESË**  
**PËR TË DHËNAT E PRONAVE TË PALUAJTSHME PËR**  
**PROCEDURËN E VLERËSIMIT TË RECIPROCITETIT**

**1. Të dhënat për pronën e paluajtshme**

| Komuna | Zona Kadastrale | Numri i Parcelës | Tipi i Pronës (Statusi pronësor: pronë private, publike | Lloji i Përdorimit (kultura) |
|--------|-----------------|------------------|---|------------------------------|
|        |                 |                  |   |                              |
|        |                 |                  |   |                              |
|        |                 |                  |   |                              |
|        |                 |                  |   |                              |

**2. Përputhja e të dhënave nga pjesa grafike dhe Regjistri i Pronave të pa luajtshme (RDPP)**

| Numri i Parcelës | Përputhet pjesa grafike me RDPP | Nuk përputhet pjesa grafike me RDPP | Vërejtje |
|------------------|---------------------------------|-------------------------------------|----------|
|                  |                                 |                                     |          |
|                  |                                 |                                     |          |
|                  |                                 |                                     |          |
|                  |                                 |                                     |          |

### 3. Të dhënat për Statusin dhe Zonën në të cilën gjendet prona:<sup>1</sup>

#### a) A ka prona statusin e:

|   |  |
|---|--|
| Pasurisë Natyrore   |  |
| Të mirës publike në përdorim të përgjithshëm                        |  |
| Pronë publike e shpallur trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë |  |

#### b) A gjendet prona në zonën:

|  |  |
|--|--|
| Brenda një (1) kilometri nga kufiti i Republikës së Kosovës  |  |
| E cila paraqet mbrojtje të interesit dhe sigurisë së shtetit e përcaktuar me ligj të veçantë se personi i huaj nuk mund të fiton pronësi në atë zonë |  |
|  |  |

#### Shënime shtesë të institucionit:

---

---

---

---

---

---

---

\_\_\_\_\_  
Emri dhe Nënshkrimi

<sup>1</sup> Nëse institucioni të cilit i është drejtuar kërkesa, nuk posedon me të dhëna ta shkruaj se “nuk ka të dhëna”



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice*

---

**INFORMATAT**  
**PËR RECIPROCITETIN PËR FITIMIN E TË DREJTËS SË**  
**PRONËSISË NË PRONA TË PA LUAJTSHME NË MES TË**  
**REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE SHTETEVE TJERA PËRVEÇ**  
**SHTETEVE ANËTARE TË BE-SË**

| <b>Nr.</b> | <b>Shteti</b> | <b>Reciprociteti<br/>Kufizimet për fitimin e të drejtës së<br/>pronësisë nga të huajt</b> |
|------------|---------------|---|
| 1          |               |   |
| 2          |               |   |
| 3          |               |   |
| 4          |               |   |
| 5          |               |   |
| 6          |               |   |
| 7          |               |   |
| 8          |               |   |
| 9          |               |   |
| 10         |               |   |